

VENDIM
Nr.164, datë 22.3.2007

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME
MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me organet e Ministrisë së Brendshme, për të plotësuar misionin e vet, në ushtrimin e kontrollit për zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet.

2. Inspektorëve të Inspektoratit Shtetëror të Punës duhet t’u krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme, për të realizuar kontrollin e personave, juridikë dhe fizikë.

3. Inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës kërkojnë bashkëpunimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, kur:

a) pengohen forcërisht nga punëdhënësit apo personat e autorizuar prej tyre, për të hyrë në mjediset e ndërmarrjes, për të ushtruar kontroll, në përputhje me legjislacionin e punës;

b) gjatë kryerjes së funksionit, jeta e tyre është në rrezik.

4. Organet e Policisë së Shtetit, në rastet e një ndërhyrjeje urgjente, pas marrjes së njoftimit, zyrtar apo gojor, nga inspektorët e punës së drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të inspektimit në punë, bashkëpunojnë me këta të fundit dhe me grupin e inspektorëve në ato subjekte, ku pengohet ushtrimi i detyrës së tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha